

## Thuajme ku u bore lule

Thuajme ku u bore lule , thuajme ku je ?  
Se te kta vinele pjot me vohë  
rruanj gjithparu e nëng të shoh !!!  
Ka dhera tënde e mbullitur një sexhë...  
Mbal murit duhet se vajton se assaj edhe i mankon....

E më dezet te një mument gjitonija pjot me gjindh  
Mbrëmanet kur zënej vera ultra gjith nguqa te dhera....  
E ti ndëmest e bukur lule shkëlqjeje si një trandafille  
çelshe mbrëndha si një zjarrë çë me dijeg njera sot....

E xura se.... Sot më neng je !  
Se te katundi ju buar gjithse  
Gaze e liri , gjuha e një shpi e gjitonija çë sot Kjan vetmi !!!

E mbijohsha pjot me mall e pjot dashuri  
Kur shtringoja dorën tëndë më fort e te buza e kuq si zjarrë  
pundarsha me buzën time më leht  
e qindrojëm pa fijal e pa frim të feshehura prapa një purtun...

e më dezet te një mument pjot me lule një ballkun  
pjot xherane e trandafille e te hjeza një macarele  
e ti prapa te dritsora prisje të arvonej hera  
të gjengdshim pa fijal e pa frim të fshehura prapa një purtun...

E xhura se... te kta vinile  
Ju thajtin gjith grastat me lule...  
E macarela spovisi xha se nëng pat fuqi të prit edhe  
si prita u e si jam e të pres se edhe sot e kam bes  
se ndëç sallvonj oj gjitonin  
sallvonj edhe oj gjuhen time.....